**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

| Data: 2.6.2023 | Nr: 655 | Ora: 09:30 |
|---|---|---|

**VENDIM**
**PËR**
**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË DIBËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**VËREN:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 325, datë 17.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Dibër. Kundër këtij vendimi është administruar kërkesa ankimore nr. 65, datë 20.05.2023, depozituar nga subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit", me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 325, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 19, "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjet e Këshillit Bashkiak Dibër".

Më datë 23.05.2023, ora 12:35, në seancën e shqyrtimit KAS vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 65, datë 20.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit".
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 325, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 19, Bashkia Dibër, "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjet e Këshillit Bashkiak Dibër".

Ky vendim i marrë nga KAS, u ankimua në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si çështja Nr.25 Regj. Themeltar, datë 26.05.2023. Me urdhërin e datës 29.05.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor "Për

caktimin e seancës gjyqësore" u caktua data 30.05.2023, ora 08:15, për zhvillimin e seancës gjyqësore në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, më datë 30.05.2023, në përfundim të shqyrtimit vendosi rrëzimin e e kërkesëpadisë.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për subjektet zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Dibër pasqyrohet në tabelën nr. 1 në vijim:

(Tabela nr. 1)

| Nr. FV | Subjekti Zgjedhor | Vota | Përqindja |
|---|---|---|---|
| 1 | Bashkë Fitojmë | 3085 | 13,14 % |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 8059 | 34,33 % |
| 3 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë | 720 | 3,07 % |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | 796 | 3,39 % |
| 5 | Partia Lëvizja e Legalitetit | 1206 | 5,14 % |
| 6 | Partia Demokracia Sociale | 213 | 0,91 % |
| 7 | Aleanca Liberale e Djathtë | 399 | 1,70 % |
| 8 | Partia Socialdemokrate | 3889 | 16,57 % |
| 9 | Partia Demokratike | 1199 | 5,11 % |
| 10 | Aleanca Progresiste L.ZH.K | 511 | 2,18 % |
| 11 | Fryma e Re Demokratike | 633 | 2,70 % |
| 14 | Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë | 105 | 0,45 % |
| 23 | Partia e Gjelbër | 261 | 1,11 % |
| 38 | Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë | 870 | 3,71 % |
| 41 | Astrit Zyber Ademi | 938 | 4,00 % |
| 42 | Agim Shaban Hysa | 588 | 2,51 % |
| | **Totali** | **23472** | 100 % |

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 31 (tridhjetë e një) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Dibër, në bazë të shkresës me nr. 212/1 Prot., datë 23.02.2023, të Prefektit të Qarkut Dibër.

Herësit e përfituar nga ky pjesëtim pasqyrohen në tabelën nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 31 (tridhjetë e një). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vijim.

(Tabela nr. 3)

| Nr. | Herësi | Subjekti |
|---|---|---|
| 1 | 8059 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 2 | 4029 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 3 | 3889 | Partia Socialdemokrate |
| 4 | 3085 | Bashkë Fitojmë |
| 5 | 2686 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 6 | 2014 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 7 | 1944 | Partia Socialdemokrate |
| 8 | 1611 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 9 | 1542 | Bashkë Fitojmë |
| 10 | 1343 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 11 | 1296 | Partia Socialdemokrate |
| 12 | 1206 | Partia Lëvizja e Legalitetit |
| 13 | 1199 | Partia Demokratike |
| 14 | 1151 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 15 | 1028 | Bashkë Fitojmë |
| 16 | 1007 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 17 | 972 | Partia Socialdemokrate |
| 18 | 938 | Astrit Zyber Ademi |
| 19 | 895 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 20 | 870 | Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë |
| 21 | 805 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 22 | 796 | Partia Republikane Shqiptare |
| 23 | 777 | Partia Socialdemokrate |
| 24 | 771 | Bashkë Fitojmë |
| 25 | 732 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 26 | 720 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë |
| 27 | 671 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 28 | 648 | Partia Socialdemokrate |
| 29 | 633 | Fryma e Re Demokratike |
| 30 | 619 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 31 | 617 | Bashkë Fitojmë |

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim.

(Tabela nr. 4)

| **Nr.** | **Subjekti Zgjedhor** | **Mandate** |
|---|---|---|
| 1 | Bashkë Fitojmë | 5 |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 13 |
| 3 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë | 1 |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | 1 |
| 5 | Partia Lëvizja e Legalitetit | 1 |
| 6 | Partia Socialdemokrate | 6 |
| 7 | Partia Demokratike | 1 |
| 8 | Fryma e Re Demokratike | 1 |
| 9 | Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë | 1 |
| 10 | Astrit Zyber Ademi | 1 |

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenet 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

**VENDOS:**

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Dibër, si më poshtë:

| **Subjekti Zgjedhor** | **Mandate** |
|---|---|
| Bashkë Fitojmë | 5 |
| Partia Socialiste e Shqipërisë | 13 |
| Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë | 1 |
| Partia Republikane Shqiptare | 1 |
| Partia Lëvizja e Legalitetit | 1 |
| Partia Socialdemokrate | 6 |

| | |
|---|---|
| Partia Demokratike | 1 |
| Fryma e Re Demokratike | 1 |
| Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë | 1 |
| Astrit Zyber Ademi | 1 |

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Dibër, si më poshtë:

**Bashkë Fitojmë**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Dafina | Bajram | Muda |
| 2 | Hajrulla | Remzi | Hoxha |
| 3 | Alketa | Sefer | Agolli |
| 4 | Petrit | Emin | Alia |
| 5 | Marjeta | Fitim | Kica |

**Partia Socialiste e Shqipërisë**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Alma | Nin | Selami |
| 2 | Erger | Dylber | Kosiqi |
| 3 | Anisa | Bardhul | Xhika |
| 4 | Tahir | Adem | Damzi |
| 5 | Irini | Arif | Shehu |
| 6 | Endri | Besnik | Leka |
| 7 | Brunilda | Bajram | Lusha |
| 8 | Sokol | Mehdi | Sava |
| 9 | Shirete | Murat | Cibaku |
| 10 | Hysen | Osman | Uka |
| 11 | Jurida | Zini | Zebi |
| 12 | Mario | Shefit | Fejza |
| 13 | Dolores | Afrim | Mikli |

**Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Burhan | Isa | Shehi |

**Partia Republikane Shqiptare**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Shukri | Idriz | Shehu |

**Partia Lëvizja e Legalitetit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Klarisa | Përparim | Balliu |

**Partia Socialdemokrate**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Florjan | Afrim | Tomçini |
| 2 | Brisilda | Qamil | Lata |
| 3 | Klevi | Setki | Ademi |
| 4 | Sara | Afrim | Tomçini |
| 5 | Pajtim | Qamil | Lata |
| 6 | Eduina | Ulvi | Ademi |

**Partia Demokratike**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Ilir | Femi | Hysa |

**Fryma e Re Demokratike**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Dali | Xhemal | Cani |

**Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Ermal | Qenan | Tuka |

**Astrit Zyber Ademi**

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**